



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **21.06.2024** NR. 64 AKTI, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt: Marrjen në pyetje dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit **“Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”** dhe **“Ndalim i daljes jashtë shtetit”**, parashikuar nga neni 234 dhe 233 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Besim Çepele** me vendimin Nr.55, date 13.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata bazuar nenet **112 dhe 248 të Kodit të Procedurës Penale** me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me vendimin Nr. 64, datë 24.06.2024, vendosi:
 1. Vazhdimin e masës së sigurimit **“Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”** dhe **“Ndalim i daljes jashtë shtetit”**, parashikuar nga neni 234 dhe 233 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Besim Çepele** me vendimin Nr.55, datë 13.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
 2. Urdhërohet personi nën hetim **Besim Çepele**, që të paraqitet përpara oficerëve të policisë gjyqësore *pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit*, **një herë në dy javë, ditën e premte në orën 15.30.**
 3. Urdhërohet personi nën hetim të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, **“Ndalim i daljes jashtë shtetit”**.
 4. Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjera identifikues të vlefshme për daljen jashtë shteti, për personin nën hetim **Besim Çepele**.
 5. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë më datë 24.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar